



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

Nr. _____ Prot.

Belsh më: 20. 10 .2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: **“Bajrami N.” shpk** me Nipt:**K02727202O**, me seli në Elbasan, Labinot fushë Xibrrakë, rruga Elb-Xibrrakë, Km 13, zk.3864 pasuritë 734/1 + 732 + 738/9, me administrator Z. Andon Prifti.

* * *

Procedura e prokurimit/lotit: *E hapur* (me mjete elektronike) Pune.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-03097-08-17-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Përmirësimi i banesave ekzistues për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara, Bashkia Belsh”**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):

Buletini i Njoftimeve Publike :

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë ka marrë pjesë Ofertuesi i mëposhtëm me këtë vlerë përkatëse të ofruar:

1. “Bajrami N.” shpk
K02727202O

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **25 738 408** (njëzet e pesë milion e shtatë qind e tridhjetë e tetë mijë e katër qind e tete) lekë pa tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. “FLED” shpk

K17621104C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **29 113 199**(njetzet e nëntë milion e njëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. BOE Colombo” shpk me Nipt:**J82916489E** dhe **MANE/S shpk** me Nipt:**J64103865K**

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **32 954 585**(tridhjetë e dy milion e nëntëqind e pesëdhjetë e kater mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

4. “ELDA-VL” shpk

K67106202W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera _____ lekë pa tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

5. “ZDRAVO” shpk

J84003411K

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **35 601 539**(tridhjetë e pesë milion e gjashtëqind e një mijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë) leke pa tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

6. “Shkëlqimi 07” shpk

K68121808W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **30 000 000**(tridhjetë milion) lekë pa tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

7. “Franko CONSTRUCTION ” shpk

K81331024A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **26 278 144** (njetzet e gjashtë milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e dyzet e katërt) lekë pa tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik **“Franko CONSTRUCTION ” shpk** me Nipt:**K81331024A**, me seli në Tirane, rruga Sulejman Delvina, Zk 8260, nr.pasurie 4/684-N17, me administrator Z.Enver Baho.

Konkretisht:

1.1 Së pari operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë e të saktë për plotësimin e pikës 2.3.1 te dokumentave standarte te tenderit,

”Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël 200% i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.”

Ndërkohe operatori **ka paraqitur një kontratë të realizuar** me entin publik konkretisht, Bashkinë Belsh **ku është në bashkëpunim** me operatorin ekonomik “Vëllezërit Hysa” **me vlerë 17 585 540 lekë pa tvsh** ku Operatori ekonomik “Franko CONSTRUCTION **ka 90% te punimeve dhe 90% e vlerës është 15 646 986 lekë pa tvsh**, konkretisht **fondi yne limit eshte 37 472 983 lekë pa tvsh dhe 50 % i fondit është 18 736 491.5 lekë pa tvsh** pra i bie që operatori nuk e permbush vleren që kërkohet nga AK.

1.2 Së dyti operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë e të saktë për plotësimin e pikës 2.3.2 Për licencat profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës sipas DST-ve.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndertim, duke përfshirë kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet tëparaqesin liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008“*Për miratimin e rregullorespër kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojne veprimtari ndertimi*”, i ndryshuar.

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
 - *N.P-1 (Punime germimi e toke)* *Niveli B*
 - *N.P-3 (Rikonstuksion dhe mirembajtje,)* *Niveli B*
- **Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
 - *N.S.-1 (Punime per prishjen e ndertimeve)* *Niveli B*
 - *N.S.-2 (Impiante hidrosanitare,)* *Niveli A*

- *N.S.-4 (Punime rifiniture te muratures,)* *Niveli A*
- *N.S.-14 (Impiante te brendshme, elektrik,)* *Niveli A*
sipas modelit të lëshuar nga MPPT;

Konkretisht operatori ka sjellë licence N.P-1 (Punime gjermime toke) Niveli A ku AK. kërkon licence N.P-1 (Punime gjermime toke) Niveli B.

Një tjetër licencë e sjellë nga OE konkretisht N:S-1 (punime për prishjen e ndërtimeve) Niveli A ku AK kërkon që licenca të jetë Niveli B.

1.3 Së katërti **operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë e të saktë për plotësimin e pikës 2.3.5.1 ku kërkohet që OE duhet të ketë në stafin e tij personel të kualifikuar: 1. Specialist të paisur me certifikatë për “ përgjegjës sigurie për mbrojtjen e shëndetit në punë” dhe dokumentat përkatëse, 2. Specialist të paisur me certifikatë (ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” me dokumentat perkatese, dhe 3. Specialist të paisur me certifikatë “për punime në lartësi” me dokumentat përkatëse.**

Ndërkohë operatori ekonomik nuk ka sjelle asnjë lloj dokumenti për personelin e kërkuar të kualifikuar.

1.4 Së pesti **operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë e të saktë për plotësimin e pikës 2.3.6 ku operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të punësuar specialistë të certifikuar sipas profesioneve të paisur me deshmi/certifikata ose cdo dokument tjetër që vërteton diplomimin si edhe kontratat individuale të punës.**

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë të certifikuar sipas profesioneve, të pajisur me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta të jete të pakten si me poshte:

- 1 Arkitekt
- 2 Teknik Ndertimi
- 2 Elektracist
- 2 Hidraulik
- 2 Murator
- 2 Bojaxhi
- 2 Pllakashtrues
- 2 suvaxhi
- 2 Karpentier
- 1 Hidroizolues
- 2 punonjes lartësie

- Për specialistët e sipercituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten: deshmitë/certifikatat ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të zbatimit të punimeve.
- Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht **2 (dy) manovratore**.
- Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht **4 (kater) shofere**.

Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata individuale e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse, kartela personale të sigurimit teknik IQT.

Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ka arritur të sjellë dokumentat e rregullt vetëm për arkitektin dhe jo për të gjithë stafin e kërkuar sipas pikës 2.3.6.

1.5 Së shtati operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë e të saktë për plotësimin e pikës 2.3.7 që OE duhet të ketë ose të vërë në dispozicion mjetet e paisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1	Kamiona vetshkarkues kapacitet mbajtës 15-20 ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
2	Kamion vetshkarkues kapacitet mbajtës mbi 20ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
3	Kamion vetshkarkues kapac mbajtes deri 10ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
4	Eskavator me goma	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
5	Kamioncine 1-3 ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
6	Kamioncine deri 3.5 ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
7	Fadromë/Skrep	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
8	Minieskavator	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>

9	Autobetoniere kantieri-2.5-3.5 m3	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
10	Autobotë uji	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>Copë 2</i>

- a. *Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; certifikate transporti, certifikate e kontrollit teknik; siguracion mjeti, (i vlefshëm).*
- b. *Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) leje qarkullimi; certifikaten e kontrollit teknik, ; certifikate transporti siguracion mjeti (i vlefshëm);*
- c. *Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.*
- d. *Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.*
- e. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.*
- f. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.*
- g. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor gjate procesit te vleresimit te ofertave.*

Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

Operatori ekonomik duhet të ketë pajisjet ndihmëse si mëposhtë:

Vibrator betoni	2 copë
Depozitë uji 1000l	10 copë
Matrapik	2 copë
Prozhektor	5 copë
Troko	5 copë
Fikse zjarri	5 copë
Kuti ndihmës së shpejtë	4 copë
Jelek	35 copë

Kokore	35 copë
Këpucë pune	35 copë
Tabela sinjalistike	10 copë

Shënim: Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Në këtë rast operatori ekonomik ka mangësi në paraqitjen e pikës së cituar më sipër, që do të thotë se në dokumentat e dorëzuara elektronikisht nga ana e OE, në SPE mungonjone dokumentacionet e parashikuar në këtë pikë, cka do të thotë që operatori ekonomik ka sjelle dokumentacion të plotë e të saktë vetëm për tre makineri dhe jo për dhjetë që kërkohet. Si edhe për më tepër operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që vërteton që ka blerë ose ka me qira paisjet ndihmëse që nevojite për realizimin e kontratës.

Se fundmi Operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë e të saktë për plotësimin e pikës 2.3.7 pika g në lidhje me kriteret e vecanta të kualifikimit ku thuhet se ; OE duhet të paraqes/in deklaratë për vendodhjen e mjeteve në pronësi ose me qira me qëllim verifikimin nga AK gjatë procesit të vlerësimit të ofertave.

Ndërkohë deklarata e cila kërkohet sipas pikës së sipër cituar nuk është paraqitur nga ana e operatorit ekonomik.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave konsiderohen si kushte për s’kualifikim.

Për sa më sipër, oferta e operatorit ekonomik “Franko CONSTRUCTION” shpk rezulton e pavleshme.

2. Operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” shpk me Nipt:K68121808W, me seli në Belishovë, Mallakastër, me administrator Z. Shkëlqim Kapllanaj.

1.1 Konkretisht në pikën 2.3.5.1

2.3.5.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij personel të kualifikuar/certifikuar si:

- 1(një)specialist/punonjës të paisur me certifikatë trajnimit për “Përgjegjës sigurie për mbrojtjen e shëndetit në punë”.

-Certifikatë “Përgjegjës sigurie për mbrojtjen e shëndetit në punë

- Diplomë
- Kontratë pune noteriale
- 1(një) **specialist/punonjës** të paisur me certifikatë trajnimit “*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave.*”
 - Certifikatë “*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave.*”
 - Diplomë
 - Kontratë pune noteriale
- 1(një) **specialist/punonjës** të paisur me certifikatë te trajnimit “*Për punime në lartësi*”.
 - Certifikatë “*Për punime në lartësi*”.
 - Diplomë
 - Kontratë pune noteriale

Në dokumentat e paraqitura nga operatori ekonomik rezulton se certifikata me nr:18071701 date 25.05.2018 e ing.Rrapi Hysaj ”*kordinator për shendetin dhe sigurine ne punë*” ka skaduar më date 25.05.2021.

Certifikata me nr:P180713 me date 24.07.2018 “*Për punime në lartësi*” e punonjsit Pellumb Kapllanaj ka skaduar me date 24.07.2021.

Certifikata me nr:P180711 me date 24.07.2018 “*Për punime në lartësi*”e punonjsit Taulant Xhemaj ka skaduar me datë 24.07.2021.

Certifikata me nr: P180717 me datë 24.07.2018 “*Për punime në lartësi*”e punonjsit Vilson Kozaj ka skaduar me datë 24.07.2021.

1.2 **Sipas pikës 2.3.7** ku kerkohen mjete dhe paisje teknike per ekzekutimin e kontratës: kërkohet eskavator me goma në pronësi ose me qira cope 1, operatori ka sjelle eskavator me zinxhir që bie ndesh me kerkesat e DST –ve.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave konsiderohen si kushte për s’kualifikim.

Për sa më sipër, oferta e operatorit ekonomik “SHKELQIMI 07” shpk rezulton e pavleshme.

3. “ZDRAVO” shpk me Nipt: **J84003411K**, me seli në Fier Lushnje, Lagjja Xhevdet Nepravishta, Ish.godina e plastmasit, me administrator Z. Dashnor Sinanaj.

1.1 Së pari operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë e të saktë për plotësimin e pikës 2.3 në lidhje me kriteret e veçanta të kualifikimit ku thuhet se

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- c. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël 200% i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
 - 1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojces 9, shoqëruar me:
 - 2. Kontratën/at ;
 - 3. Situacionin përfundimtar të objektit;
 - 4. Aktin e kolaudimit;
 - 5. Fatura tatimore perfundimtare.

(Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.)

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve, shoqëruar me:
 - 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 - 3. Situacionin përfundimtar të objektit;
 - 4. Aktin e kolaudimit;
 - 5. Fatura tatimore perfundimtare.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”).

Punë të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa tvsh).

Ndërkohe operatori **ka paraqitur kontrata të realizuar** me ente publike publike konkretisht me Bashkinë:

1. Kontratë me Bashkinë Prrenjas me nr. Prot 2973 datë 25.10.2018 me vlerë **13 296 931** lekë pa tvsh.
2. Kontratë me Bashkinë Kucovë me nr.prot 3050 datë 12.09.2018 me vlerë **12 145 527** lekë pa tvsh.
3. Kontratë me Bashkinë Cerrik me nr. Prot.3151 datë 26.09.2018 me vlerë **17 362 113** lekë pa tvsh.

Fondi ynë limit është 37 472 983 lekë pa tvsh, **50% i fondit është 18 736 491.5** cka do të thotë që operatori ekonomik nuk e përmbush realizimin e pikës 1.1 sic kërkohet ne SPE.

Sipas pikës së dytë operatori ka realizuar kontrata **me ente publike të marra së bashku me një shumë 42 804 571 lekë** pa tvsh. Ndërkohë sipas pikës duhet që **vlera totale** e kontratave të realizuara **të jetë sa dyfishi i fondit limit që i bie 74 945 966** lekë pa tvsh, rrjedhimisht operatori ekonomik nuk e përmbush as këtë pikë, duke mos realizuar pikën 2.3.1 të DST- ve.Në zbatim të VKM nr.285 date 19.05.2021 ‘për rregullat e prokurimit publik’ neni 39 pika 5 thuhet:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për sa më sipër, oferta e operatorit ekonomik “ZDRAVO” shpk rezulton e pavleshme.

- 4. 'ELDA-VL' shpk** me Nipt:**K67106202W**, me seli Vlorë lagja 10 korriku, rruga Pelivan Leskaj, sheshi i zhvillimit ne truallin me nr.pasurie 19/223, ZK. me nr. 8602. me administrator Z. Artan Hoxhaj.

Konkretisht operatori ekonomik nuk ka ngarkuar asnjë dokument në SPE cka e ben të pavlefshëm pjesmarrjen e tij në këtë procedurë prokurorimi.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave konsiderohen si kushte për s'kualifikim.

Për sa më sipër, oferta e operatorit ekonomik “ELDA-VL” shpk rezulton e pavleshme.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“Bajrami N.” shpk** me Nipt:**K027272020**, me seli në Elbasan, Labinot fushë Xibrrakë, rruga Elb-Xibrrakë, Km 13, zk.3864 pasuritë 734/1 + 732 + 738/9, me administrator Z. Andon Prifti, është paraqitur me ofertë ekonomike **25 738 408 (njëzet e pesë milion e shtatë qind e tridhjetë e tetë mijë e katër qind e tete) lekë pa tvsh dhe 30 886 089.6(tridhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë e nëntë pike gjashtë) lekë me tvsh.**

dhe/ totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
K R Y E T A R I
Arif TAFANI